



Pranuar / Dorezuar Priljen / Prodato Received / Delivery	11.12.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSKOR	7415/2023		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1276/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi -anëtar, dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1276/2023 të datës 12.10.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë: rruga Nr.4, Komuna e Istogut, kundër organit të punësimit Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 11.12.2023 njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Detyrohet Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij Vendimi të nxjerrë akt administrativ lidhur me kërkesën me numër protokolli Nr.1206/2023 të parashtruar nga ankuesi

II. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë Vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/968/2021 të datës 06.08.2021 në pozitën e punës „Zyrtarë i Lartë i Burimeve Njerëzore” në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Më datë 01.03.2023 U.D. i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ka nxjerr Vendim me numër reference DPSKPK/Nr./89/2023 dhe numër të protokollit Nr.prot.341/2023, përmes së cilit e ka shfuqizuar Vendimin me numër reference DPSKPK/Nr.86/2023 dhe numër të protokollit nr.337/2023, për caktimin e Sh.H .Udhëheqëse e Zyrës për Administrimin e Dokumenteve dhe Arkivim, Zyrtar Kontaktues mes Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, kurse në pikën II të dispozitivit të këtij Vendimi ankuesi _____ Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore caktohet Zyrtar kontaktues mes Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ankuesi më datë 10.08.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokollit Nr.prot.1206/2023 , tek U. D. i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes së cilës ka kërkuar lejimin e shtesave për vëllimin në punë sipas nenit 25 dhe nenit 47 të Rregullores me numër Nr.03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial. Ndërsa . D. i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me heshtjen administrative të U.D. të Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial, më datë 12.10.2023 përmes emailit ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë me numër protokollit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se me Vendimin me numër reference DPSKPK/Nr./89/2023 dhe numër të protokollit Nr.prot.341/2023 të datës 01.03.2023 të U.D. i Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial, si Zyrtar Kontaktues në mes të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i janë caktuar detyra shtesë dhe i është rritur vëllimi i punës duke tejkalluar detyrat e punës të cilat i ka në përshkrimin e detyrave të punës si Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 17.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa Këshilli me datën 23.10.2023 ka pranuar përgjigje nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6518/2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për lejimin e shtesave për vëllim në punë me numër protokollit Nr.prot.1206/2023 të datës 10.08.2023; Vendimin me numër DPSKPK/Nr./89/2023 dhe numër protokollit 01.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.10.2023; Përgjigje në kërkesë me numër DBNJ 284/2023 dhe numër protokollit Nr.prot.1669/2023 të datës 23.10.2023; Akt Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK/968/2021 të datës 06.08.2021; Përshkrimi i detyrave të punës; Email i datës 15.09.2023 nga S.Gj drejtuar Sh.H; E-mailin e datës 05.12.2023; Ligji me Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Ddhuratave; Rregullorja Nr.03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistem Prokurorial.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosjen e kësaj çështje, duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e parashtruara të lëndës dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për detyrimin e organit punëdhënës, respektivisht udhëheqësin me te lartë administrativ në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial, që t'i ndër marr të gjitha veprimet ligjore për të vendosur lidhur me kërkesën me numër protokollit Nr.prot.1206/2023 të datës 10.08.2023 te parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar, se ankuesi është i punësuar sipas Akt Emërimit me numër DBNJ/DPSKPK-968/2021 të datës 06.08.2021, në pozitën e punës „Zyrtar i Lartë i Burimeve Njerëzore” në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Tutje ankuesi sipas Vendimit me numër DPSKPK/Nr.89/2023 të protokolluar me numër protokollit Nr.prot.341 të datës 01.03.2023 të nxjerre nga U.D. i Drejtorit i Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është caktuar si Zyrtar Kontaktues në mes Sekretariatit të Këshillit Prokurorial dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se ankuesi sipas Vendimit me numër me numër reference DPSKPK/Nr.86/2023 dhe numër të protokollit Nr.337/2023, të datës 01.03.2023 të U.D të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, është caktuar, Zyrtar Kontaktues mes Sekretariatit të Këshillit Prokuorial të Kosovës dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

Ankuesi më datë 10.08.2023, ka parashtruar kërkesë me numër protokollit Nr.prot.1206/2023 tek U.D i Drejtorit i Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës duke kërkuar lejimin e shtesave për vëllim të punës sipas Rregullores me numër Nr.03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se U.D. i Drejtorit i Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk e ka shqyrtuar kërkesën me numër protokollit Nr.1206/2023 të datës 10.08.2023, respektivisht nuk ka ndër marrë asnjë veprim juridik për të proceduar dhe adresuar kërkesën për realizimin e të drejtës së pretenduar për lejimin e shtesave për vëllim të punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht dispozitat e nenit 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave*, ndërsa me dispozitat e nenit 13 dhe 28 paragrafi 7 të Ligjit me numër Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorit Publik, janë përcaktuar rastet se kur nëpunësit civile kane të drejtë të marrin kompensim të pagës: *13.„Paga e nëpunëses/it civile përbëhet nga paga bazë, shtesat dhe kompensimet, kur shtesat dhe kompensimet janë të aplikueshme sipas këtij ligji”, ndërsa me neni 28 paragrafin 7 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik përcaktohet se: “28. Shtesa për vëllimin e punës, 7.Kriteret dhe procedura për përfitimin e shtesës sipas këtij neni, në Presidencën e Republikës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë,*



Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të institucioneve” andaj Kolegji ka konstatuar se lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit në rastin konkret e drejta për shtesë apo kompensim për shkak vëllimit të punës për të punësuarit në sistemin prokurorial është rregulluar me akt të veçantë të miratuar me datë 27.07.2023 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës përkatësisht me dispozitat e nenit 25 dhe 26 të Rregullores Nr.03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial ku janë përcaktuar kriteret dhe procedurat për përfitimin e shtesës për vëllimin e punës.

Andaj, duke marr parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji konstaton se Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës është i obliguar që të ndërmarr veprime ligjore për shqyrtimin e kërkesës me numër protokollit Nr.1206/2023 të datës 10.08.2023 të parashtruar nga ankuesi në mënyrë që të vërtetojë drejtë gjendjen faktike dhe rrjedhimisht të nxjerr akt administrativ në pajtim me dispozitat e Ligjit me numër Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorit Publik, Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores Nr.03/2023 për Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit në Sistemin Prokurorial.

Kolegji pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e Kryetares të Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1276/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit të Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit të Këshillit të Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

